



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi

Datë: 10.01.2019

(dy): 1 seancë dëgjimore + 1 seancë dhënie vendimi

Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut" – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).

A. Informacioni bazë

Institucioni dhe tema:	<i>Institucioni: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e më poshtë KPK). Objekti: Procesi i Vettingut të subjektit të rivlerësimit Znj. Alma Muca</i>
Emri i subjektit të rivlerësimit	<i>Znj. Alma Muca</i>
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	<i>Prokurore, në Prokurorinë e Përgjithshme</i>
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	<i>Seanca u zhvillua e plotë, në intervalin kohor 09:00-09:47. Trupa gjyquese e KPK u tërhoq për të marrë vendimin, duke shtyrë seancën me 4 ditë.</i>
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	<i>Shpallja e vendimit është shtyrë për dt. 14 janar, ora 09:30.</i>

B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca

Trupa gjyquese (emrat)	<i>Suela Zhegu - Kryesuese e trupit gjyques; Valbona Sanxhaktari - Relatore e çështjes; Brunilda Bektoshi - anëtare e trupit gjyques. Të pranishëm pa shkëputje gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.</i>
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	<i>Në cilësinë e vëzhguesit ndërkombëtar paraqitet, Znj. Mia Raising. E pranishme pa shkëputje gjatë zhvillimit të seancës.</i>
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	<i>Mbrojtja u realizua personalisht.</i>
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	<i>Albana Misja</i>
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	<i>Numri i anëtarëve nga publiku konstatohet të jetë rreth 15 persona, pavarësisht masave të sigurisë, me akses të plotë në hyrjen e godinës dhe pjesëmarrje fizike në seancën dëgjimore. Akomodimi u krye në formë të rregullt nga stafi menaxhues i KPK.</i>
Media e pranishme:	<i>Mediat lokale ishin të pranishme, me përafërsisht 2 përfaqësues, me akses të plotë në hyrjen e godinës. Megjithatë pjesëmarrja e tyre u lejua vetëm në fazën përgatitore të seancës dëgjimore, pas së cilës largohen nga salla së bashku me mjetet e regjistrimit, referuar nenit 3 të Rregullores "Për marrëdhëniet me median".</i>

C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	Po/Jo	Nëse po, si u justifikua ai?	Nëse jo, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj?
D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kriterëve)	Argumenti	kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës?
D1. Pasuria	Referuar të dhënave në Raportin Vlerësues të ILDKPKI dorëzuar pranë Komisionit, në lidhje me subjektin e rivlerësimit konstatohet se: Deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin, dhe subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; nuk ka mos deklarime të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë; nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.	Të dhëna nga raportet e ILDKPKI	Komisioni nuk deklaroi në seancën dëgjimore aktet provuese mbi të cilat mbështeti rezultatet e hetimit administrativ për kriterin e Pasurisë
	Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, dhe kryerja e hetimit administrativ të pavarur, KPK konstaton pasuritë si më poshtë: 1. Depozitë bankare BKT, si mbledhje e depozitave të mëparshme. Konstatohet përputhje deklarimesh nga subjekti. 2. Auto KIA, në vlerën 17500 Euro. Burim krijimi pjesërisht nga shitja e një auto të mëparshme, dhe pjesërisht hua nga i ati (vlerë e cila është shlyer pjesërisht dhe pjesa e mbetur është falur). Nga hetimi i Komisionit është konstatuar burim i ligjshëm i të ta ardhurave të të atit, të cilat janë të mjaftueshme për të justifikuar huanë e dhënë. 3. Person tjetër i lidhur (e ëma). Në pronësi të plotë (pjesë takuese 100%), Apartament banimi, Durrës, në vlerën 28182 m2, Burim krijimi: kursimet e të dy prindërve. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se ka burime të plota financiare për të justifikuar tjetërsimin e pronësisë. 4. 2 apartamente banimi, 96 dhe 32 m2. Burim krijimi: trashëgimi pas vdekjes së të atit (ndarë sipas trashëgimisë ligjore. Konstatohet se është hequr dorë nga pjesët takuese disponuar nga e ëma dhe i vëllai, dhe i janë dhuruar subjektit të rivlerësimit). Pjesa e mbetur e vlerës së pasurive të mësipërme është përftuar nga shitja e një Apartamenti në Dibër. Lidhur me këtë pasuri Komisioni konstatoi mospërputhje mes deklarimeve të subjektit (i cili deklaroi shitjen e pasurisë më 1996) dhe të ZRPP Dibër (i cili deklaroi shitjen e pasurisë më 2000). Për këtë i është kaluar barra e provës subjektit. Komisioni nuk deklaroi në seancën dëgjimore aktet provuese ku mbështet hetimin e pavarur	Relatori	
		Mbrojtja	
	Subjekti i rivlerësimit konfirmon marrjen e dëgjimit mbi dosjen dhe dokumentet provues.	Subjekti i rivlerësimit	
		Ankesa nga publiku	
	Përfaqësuesi i ONM		
	Të dhënat nga raporti i DSIK, në përputhje me N.39 të ligjit 84/2016, konstatojnë vlerësimin: "I Përshtatshëm" për vazhdimin e zhvillimit të detyrës	Të dhëna nga raportet e DSIK	Komisioni nuk deklaroi në seancën dëgjimore aktet provuese mbi të cilat mbështeti rezultatet e hetimit

D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Relatori i çështjes referoj për diskutim çështjen e përfolur mediatike çështja "Cole", proceduar nga Gjykata e Lartë, ku pretendohet se prokurori i çështjes ka ndryshuar kualifikimin ligjor te veprës, për qëllime të aferave korruptive. Organi i ndjekjes penale, investuar nga kallëzimi i familjarëve të palëve, vendosi mos fillimin e procedimit penal, me argumentin se fakti nuk parashikohet si vepër penale. Lidhur me këtë çështje i është kaluar barra e provës subjektit të rivlerësimit, për të argumentuar menaxhimin që ka bërë për këtë çështje, meqë në atë kohë mbartte cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë. Subjekti u mbrojt duke referuar në amendimet e fundit ligjore, të cilat decentralizojnë pushtetin e prokurorit, dhe heqin kompetencat e drejtuesit për të ndërhyrë në qëndrimin e prokurorit të çështjes.	Relatori	mbeshtet rezultatat e hetimit administrativ për kriterin e Figurës
		Mbrojtja	
	Subjekti i rivlerësimit konfirmon marrjen dijani mbi dosjen dhe dokumentat provues. Aprovon vendimmarrjen e DSIK.	Subjekti i rivlerësimit	
		Ankesa nga publiku	
	Parashtrroj pyetjet: 1-Ka mundësi ligjore për drejtuesin e prokurorisë, për të raportuar qëndrimin dhe çështje parregullsie që konstatoj në çështjen Cola, në një instancë tjetër? 2- Në media rezultojnë se ka një urdhër pezullimi nga Prokurori i Përgjithshëm për prokurorin e çështjes dhe subjektin. Pse nuk u gjet në dosje një informacion i tillë? Subjekti përsëriti argumentin e dhënë në Komision gjatë kalimit të barrës së provës	Përfaqësuesi i ONM	
D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	Të dhënat raportojnë se: subjekti i rivlerësimit ka cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë dhe ka njohuri ligjore të plota. Vlerësohet me shume mirë	Të dhëna nga grupi i punës së Prokurores së Përgjithshme	Provat e administruara parashtruar në seancë dëgjimore: Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale të grupit të punës së Prokurorisë së Përgjithshme, 3 dosje të përzgjedhura nga subjekti dhe 5 të përzgjedhura në formë rastësore
		Relatori	
		Mbrojtja	
	Subjekti i rivlerësimit konfirmon marrjen dijani mbi dosjen dhe dokumentat provues. Miraton deklaratimet e KPK mbi përfundimet e hetimit administrativ lidhur me këtë pikë	Subjekti i rivlerësimit	
		Ankesa nga publiku	
	është deklaruar denoncim nga ONM lidhur me organizimin e punës së subjektit dhe lidhjen me prokurorin e çështjes në lidhje me aludimet mediatike te çështjes "Cole"	Përfaqësuesi i ONM	
E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	Aksesi i pjesëmarrjes, nga publiku, shoqëria civile, institucionet e tjera të interesuara dhe mediat lokale është respektuar. Etika e sjelljes së trupit gjykues është e rregullt dhe të folurit të kuptueshëm. Deklarohen nga relatori i çështjes dhe konfirmohen nga subjekti respektimi i te drejtave procedurale si: është njoftuar për procedurën e fillimit të rivlerësimit dhe përbërjen e trupës gjykuese, për të cilët nuk ka pasur deklaram për konflikt interesi. është njohur me dokumentat e dosjes dhe të drejtat e saj në përputhje me K.Pr. A. i janë dhënë disa ditë kohë për tu njohur me dosjen, dhe për të disponuar kopje të saj, si dhe iu bënë të ditura rezultatet e hetimit administrativ. i rezervohet e drejta përfaqësuesit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, dhe trupit gjykues të drejtojnë pyetje, dhe iu dha mundësia e fjalës në seancë dëgjimore subjektit të rivlerësimit. Kohëzgjatja e seancës dëgjimore është e arsyeshme (47 minuta). Trupi gjykues tërhoqet për shpalljen e dispozitivit të vendimit, duke shtyrë dhënien e vendimit me 4 ditë. Sa më sipër, seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit plotëson kriteret që referon ligji nr. 84/2016, Kodi i Procedurës Administrative (Nenet 45-47) dhe Aneksi shtojcë i Kushtetutës, referuar te drejtave procedurale dhe respektimit të elementeve përbërës të procesit të rregullt ligjor, mbrojtjes efektive, aksesit në gjykim, kohëzgjatjes së arsyeshme të seancës. Megjithatë, Komisioni vazhdon të mos referoj në formë transparente aktet provuese te hetimit të pavarur administrativ që ka administruar për të nxjerrë konkluzionet e kalimit të barrës së provës subjektit.		